



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2404 Prot.

Tiranë, më 15 /07 /2026

V E N D I M

Nr. 17, datë 10.07.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
FIZIKE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE
DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 176, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Optimizimi dhe Vlerësimi i Strategjive të Mbrojtjes nga Rrezatimi për Punonjësit, Pacientët dhe Publikun;
2. Qarqe kaotike të bazuara në memristorë fizikë: modele, eksperimente dhe aplikime;
3. Vetitë dhe aplikimet e tretësve eutektikë të thellë: studim eksperimental dhe analizë teorike;
4. Zhvillimi i softuerit dhe firmware-it për elektronikën dhe logjikën e leximit të sistemit RPC në CMS-CERN duke përdorur FPGA.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Fizike, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

